

Presidenti i Federatës Evropiane të Futbollit (UEFA) ka dhënë një deklaratë para vendimit të Komisionit të Disiplinës së organizatës më të madhe evropiane për futboll, në lidhje me ndeshjen e ndërprerë midis Serbisë dhe Shqipërisë.

Francezi ka thënë se skenat që ndodhen në stadiumin e Partizanit të Beogradit ishin të turpshme dhe skandaloze, ndërsa ka paralajmëruar se te dyja kombëtaret do të ndëshkohen, transmeton Telegrafi.

"Lufta jonë kryesore është që të eliminojmë skena të ngjashme çfarë ndodhën në Beograd. Skenat ishin të turpshme dhe skandaloze. E kam thënë dhe e them prapë, politika nuk ka vend në futboll dhe nuk do të ketë kurrë. Ata që shkaktuan incidentin në Beograd do të dënohen ashpër dhe të dy Federatat të bëhen gati për ti pranuar dënimet" ka thënë Platini.

Kujtojmë se ndeshja në mes të Serbisë dhe Shqipërisë është ndërprerë më 14 tetor, para përfundimit të pjesës së parë, kur tifozët serbë u futën në fushë dhe sulmuan futbollistët shqiptarë. /Telegrafi/